



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:127398

Datë: 19.09.2024

Numri i dokumentit: 06180896

C.nr.2058/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, me bashkëpunëtoresh profesionale B.G. në çështjen kontestimore të paditësve V.S., A.D., E.S., A.M. dhe A.H. që të gjithë nga Komuna e Prizrenit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. V.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës, Prishtinë, me objekt të kontestit pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 2,489.70 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, me datë 19.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve V.S., A.D., E.S., A.M. dhe A.H. që të gjithë nga Komuna e Prizrenit.

II. DETYROHET e paditura M.A.Sh.T. me seli në Prishtinë, që paditësit të kompensohen në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit, dhe atë:

- Paditësit V.S.
 1. Për periudhën kohore 01.06.2019 - 31.12.2019, në shumën prej 86.75 euro.
 2. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 11.01 euro.
 3. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 187.20 euro.
 4. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 30.04.2022, në shumën prej 212.97 euro apo në shumën e përgjithshme prej 497.94 euro.
- Paditëses A.D.
 1. Për periudhën kohore 01.06.2019 - 31.12.2019, në shumën prej 86.75 euro.
 2. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 11.01 euro.
 3. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 187.20 euro.
 4. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 30.04.2022, në shumën prej 212.97 euro apo në shumën e përgjithshme prej 497.94 euro.
- Paditëses E.S.
 1. Për periudhën kohore 01.06.2019 - 31.12.2019, në shumën prej 81.97 euro.
 2. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.41 euro.
 3. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 177.00 euro.
 4. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 30.04.2022, në shumën prej 201.34 euro apo në shumën e përgjithshme prej 470.72 euro.

- Paditësit A.M.
 1. Për periudhën kohore 01.12.2019 - 31.12.2019, në shumën prej 11.71 euro.
 2. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.41 euro.
 3. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 177.00 euro.
 4. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 30.04.2022, në shumën prej 201.34 euro apo në shumën e përgjithshme prej 400.46 euro.

- Paditëses A.H.
 1. Për periudhën kohore 01.06.2019 - 31.12.2019, në shumën prej 81.97 euro.
 2. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.41 euro.
 3. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 177.00 euro.
 4. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 30.04.2022, në shumën prej 201.34 euro; apo në shumën e përgjithshme prej 470.72 euro.

Të gjitha këto shuma me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, për secilin paditës e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë më datë 21.06.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve t'ia paguaj shumën prej 342.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 2,489.70 euro, përkatësisht shuma prej 151.92 euro, konkretisht shuma prej 27.22 euro për paditësen E.S. dhe A.H. si dhe shuma prej 97.48 euro për paditësin A.M. në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

A r s y e t i m

Paditësit V.S., A.D., E.S., A.M. dhe A.H. që të gjithë nga Komuna e Prizrenit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. V.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë ushtruar padi, kundër të paditurës M.A.Sh.T. Prishtinë, me objekt të kontestit pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 2,303.00 euro, duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga viti 2017 deri në muajin maj të vitit 2022, duke theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune pranë Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim "Nënë Tereza" në Prizren, dhe bazuar në nenin 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë.

Me parashtrësën e datës 30.07.2024, paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe atë sa i përket shkallës së përqindjes së inflacionit si dhe periudhën kohore për të cilën kërkojnë kompensimin në emër të inflacionit. Ashtu që, për vitin 2019 inflacioni ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve ka qenë 459 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për 7 muaj të vitit 2019 është 86.75 euro. Për vitin 2020 inflacioni ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve ka qenë 459 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është

dashur të futej në pagën bazë për 12 muaj të vitit 2020 është 11.01 euro. Për vitin 2021 inflacioni ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve ka qenë 459 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për 12 muaj të vitit 2021 është 187.20 euro. Për vitin 2022 inflacioni ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve ka qenë 459 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për 4 muaj të vitit 2022 është 212.97 euro. Si përfundim, për secilin paditësit ka kërkuar kompensimin në emër të inflacionit për periudhën kohore nga data 01.06.2019 deri me datë 30.04.2022, për secilin paditës nga 497.94 euro. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura M.A.Sh.T dhe Inovacionit, Prishtinë, përmes të autorizuarës së saj Avokaturës Shtetërore të Republikës së Kosovës, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Ka theksuar se nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura MASHT dhe gëzojnë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, por që paditësit kërkesën e tyre e kanë mbështetur në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, dhe nuk kanë dëshmuar se janë anëtar të sindikatës ashtu siç parashihet me nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate. Për realizimin e kësaj të drejte nuk janë krijuar mundësitë institucionale-financiare. Gjithashtu e njëjta ka theksuar se konform nenit 341 të LMD-së, me parashkrimi shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Ndërsa par.2, Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Gjithashtu, M.A.Sh.T. përmes njoftimit të datës 21.11.2022, ka njoftuar për shpëputjen e njëanshme të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të datës 30.07.2024, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe nenin 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga kontratat e punës të nënshkruara nga paditësit përkatësisht për paditësin V.S. kontrata me nr. protokollit: 3/1048-261 e nënshkruar me datë 12.10.2018, për paditësen A.D. kontrata me nr. të protokollit: 3-7/1048-321 e nënshkruar me datë 01.11.2021, për paditësen E.S. kontrata me nr. të protokollit: 2-2271-1 e nënshkruar me datë 15.02.2017, për paditësin A.M. kontrata me nr. të protokollit: 3-7/1048-316 e nënshkruar me datë 01.12.2020 dhe për paditësen A.H. kontrata me nr. të protokollit: 3/1048-27 e nënshkruar me datë 30.05.2019, në njërën anë dhe të paditurës në anën tjetër, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza” në Prizren.

Po ashtu, bazuar në Listat e Pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësve V.S. dhe A.D. e që është shuma prej 459.00 euro, ndërsa paditësit E.S., A.M. dhe A.H. kanë pagën në lartësi prej 434.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeks të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarra

apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Për paditësit: V.S. dhe A.D.

- Për periudhën 01.06.2019 – 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 86.73 euro ($459 * 2.7\% = 12.39 * 7 \text{ muaj} = 86.73 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 11.01 euro ($459 * 0.2\% = 0.918 * 12 \text{ muaj} = 11.01 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 187.20 euro ($459 * 3.4\% = 15.60 * 12 \text{ muaj} = 187.20 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2022 – 30.04.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 212.96 euro ($459 * 11.6\% = 53.24 * 4 = 212.96 \text{ euro}$).

Ndërsa për paditësit: E.S. dhe A.H.

- Për periudhën 01.06.2019 – 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 434.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 81.97 euro ($434.00 * 2.7\% = 11.71 * 7 \text{ muaj} = 81.97 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 434.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.41 euro ($434.00 * 0.2\% = 0.868 * 12 \text{ muaj} = 10.41 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021 ka

qenë 434.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 177.00 euro ($434.00 * 3.4\% = 14.75 * 12 \text{ muaj} = 177.00 \text{ euro}$).

- Për periudhën 01.01.2022 – 30.04.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 434.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 201.34 euro ($434.00 * 11.6\% = 50.34 * 4 = 201.34 \text{ euro}$).

Ndërsa për paditësin A.M. kompensimi në emër të inflacionit për vitin 2019 fillon të llogaritet nga muaji dhjetor i vitit 2019, për faktin se bazuar në vërtetimin me numër protokollit 209/2022 i datës 04.05.2022, të lëshuar nga drejtori i shkollës Q.B.M.K., gjykata ka vërtetuar faktin se i njëjti ka themeluar marrëdhënien e punës me datë 01.12.2019, ashtu që të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëdhënie e punës kanë efekt juridik nga momenti i themelimit të së njëjtës, andaj paditësit A.M. për vitin 2019 konkretisht muajin dhjetor në emër të inflacionit në pagë i takon shuma prej 11.71 euro, ndërsa për periudhën tjetër e deri me datë 30.04.2022, i takon në mënyrë të njëjtë me paditësit E.S. dhe A.H. të kalkuluar si më lartë.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, pasi që gjykata e vlerësoi të pa bazuar pretendimin e palës paditëse sa i përket lartësisë së pagës bazë të E.S., A.M. dhe A.H. për faktin se nga lista e pagave gjykata ka vërtetuar se të njëjtit kanë pagën bazë në shumën prej 434.00 euro, e jo siç kanë pretenduar paditësit se është në lartësi prej 459.00 euro, andaj bazuar në pagën 434.00 euro, gjykata ka bërë llogaritjen e përqindjes së inflacionit në pagë. Gjithashtu gjykata e vlerësoi të pa bazuar pretendimin e palës paditëse sa i përket paditësin A.M. lidhur me periudhën kohore për të cilën ka kërkuar kompensimin në emër të inflacionit në pagë, për faktin se i njëjti ka filluar marrëdhënien e punës nga data 01.12.2019, andaj të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëdhënie kanë efekt juridik nga momenti i themelimit të së njëjtës pra nga data 01.12.2019, ashtu që shumën prej 151.92 euro e ka refuzuar të pa bazuar, konkretisht shumën prej 27.22 euro për secilin paditës E.S. dhe A.H. ndërsa shumën prej 97.48 euro për paditësin A.M. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (21.06.2022) bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata mori parasysh pretendimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar dhe nuk ka mbështetje juridike.

Më konkretisht, me nenin 87 të Ligjit të Punës përcaktohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Rrjedhimisht, paditësja padinë e ka parashtruar në gjykatë më datë 21.06.2022, që do të thotë se ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe nuk ka arritur afati i nevojshëm i përcaktuar më lartë, në mënyrë që të konsiderohet e parashkruar kërkesa e paditëses. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 30.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 342.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.2058/2022, datë 19.09.2024

G j y q t a r i
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.